



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. 02/986 Dt. 29 / 04 / 2024

Në mbështetje të nenit 23 pika nën paragrafi 1.3 si dhe nenit 159 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, Këshilli Drejtues në mbledhjen e tridhjetë e pesë (XXXV) të mbajtur më datë 26.04.2024, miraton këtë:

**RREGULLORE PËR VEPRIMTARINË KËRKIMORE - SHKENCORE NË
UNIVERSITETIN PUBLIK "KADRI ZEKA" GJILAN**

**Kapitulli I
Dispozitat e përgjithshme**

Neni 1

1. Me këtë Rregullore organizohet veprimtaria kërkimore - shkencore, të drejtat dhe detyrimet e organeve kompetente të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan (në tekstin e mëposhtëm UKZ), të pjesëmarrësve të veprimtarisë kërkimore - shkencore dhe publikimin e rezultateve kërkimore - shkencore.

Neni 2

1. Stafit akademik i UKZ-së është i obliguar të bëjë kërkime shkencore në përputhje me aftësitë e tyre profesionale dhe obligimet që dalin nga dokumentet strategjike të UKZ-së. Çdo anëtar i stafit akademik, do të vlerësohet një herë në vit për kontributin e tij në veprimtarinë shkencore.

Neni 3

1. UKZ krijon kushtet për veprimtari kërkimore – shkencore duke ndihmuar stafin akademik edhe financiarisht që të arrijë rezultate konkurruese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Neni 4

1. Veprimtaria kërkimore – shkencore përfshinë hulumtimet dhe kërkimet shkencore në përputhje me Ligjin nr. 04/L-135 për veprimtari kërkimore – shkencore.
2. Veprimtaria kërkimore - shkencore përfshin këto aktivitete:
 - 2.1. Realizimin e hulumtimeve themelore, të avancuara dhe aplikative me qëllim të zhvillimit të hulumtimit shkencor në fushat studimore në përputhje me statutin e UKZ-së;
 - 2.2. Organizimin e konferencave e shkencore vendore, rajonale dhe ndërkombëtare, të punëtorive dhe seminareve;
 - 2.3. Hulumtimin shkencor në bashkëpunim me institucionet e tjera hulumtuese në vend dhe jashtë;
 - 2.4. Bashkëpunimin me institucionet publike dhe jopublike si dhe subjektet ekonomike;
 - 2.5. Përgatitjen e studimeve nga fushat studimore konform nenit 85 të statutit të UKZ;
 - 2.6. Patentimin;
 - 2.7. Përgatitjen e ekspertizës në fushat sipas nënparagrafit pesë të këtij neni dhe kontrollin e cilësisë së dokumentacionit teknik;
 - 2.8. Përpilimin e programeve investuese dhe programeve të tjera;
 - 2.9. Organizimin e seminareve dhe zhvillimin profesional të stafit akademik në lëmi shkencore relevante për UKZ-në;
 - 2.10. Veprimtarinë botuese (botimin e teksteve universitare, monografive dhe revistave shkencore); dhe,
 - 2.11. Veprimtarive të tjera kërkimore - shkencore në fushat që mbulojnë me programet studimore në UKZ.

Neni 5

1. Veprimtaria kërkimore - shkencore nga ana e instituteve realizohet në formë të kërkimeve themelore dhe kërkimeve të aplikuara që janë në lidhje të ngushte me nevojat e interesit publik.
2. Bartësi kryesor i aktiviteteve kërkimore- shkencore është stafi akademik i UKZ-së.
3. Staf i akademik në çdo takim apo ngjarje shkencore që mbështetet nga UKZ duhet të paraqitet si staf i UKZ me simbolet dhe adresat e komunikimit zyrtar të UKZ-së.

Kapitulli II

Organizimi

Neni 6

1. Në përputhje me “Strategjinë për veprimtari dhe kërkime shkencore në UKZ”, prorektori për kërkime shkencore në bashkëpunim me Zyrën për kërkime shkencore, është përgjegjës për:

- 1.1. Udhëheqjen e aktiviteteve të hulumtimit në UKZ, në pajtim me Misionin dhe Planin Strategjik;
- 1.2. Bashkëpunimin ndërkombëtar shkencor;
- 1.3. Planin vjetor të UKZ-së për punë kërkimore - shkencore së bashku me buxhetin vjetor për hulumtim shkencor;
- 1.4. Koordinimin dhe përparësinë e planit dhe aktiviteteve të propozuara hulumtuese shkencore;
- 1.5. Informimin e organeve udhëheqëse UKZ-së rreth aktiviteteve hulumtuese dhe përfaqësimin e këtyre aktiviteteve brenda dhe jashtë shtetit;
- 1.6. Përpilimin e politikave, rregulloreve, dhe procedurave për rregullimin e veprimtarisë hulumtuese;
- 1.7. Konfirmimin e kërkesave për financimin e hulumtimit;
- 1.8. Ndjekjen e pagesave rreth kompensimeve për punët e realizuara, shërbimeve të dhëna dhe furnizimit me material dhe mjete pune për koordinatorët e projekteve;
- 1.9. Evidentimin dhe ruajtjen e kontratave me shfrytëzuesit e shërbimeve;
- 1.10. Shpenzimet për materialet teknike për hulumtim dhe infrastrukture hulumtuese;
- 1.11. Organizimin e konferencave, punëtorive, seminareve apo forumeve shkencore;
- 1.12. Botimin e revistave shkencore;
- 1.13. Përkrahjen e zhvillimit shkencor të stafit akademik;
- 1.14. Koordinimin dhe monitorimin e projekteve hulumtuese;
- 1.15. Përkrahjen e aplikimeve për projekte hulumtuese të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare;
- 1.16. Koordinimin e bazës së të dhënave për hulumtim;
- 1.17. Menaxhimin dhe organizimin e shpërblimit “Hulumtuesi më i mirë i vitit”; dhe,
- 1.18. Realizimin e aktiviteteve tjera lidhur me veprimtarinë hulumtuese.

Neni 7

Detyrat dhe përgjegjësitë e Prorektorit pre hulumtime shkencor

- 1.1. Prorektori/ja për Hulumtime dhe Kërkime Shkencore, është përgjegjës lidhur me kërkesat për publikimet shkencore nga Stafit Akademik,
- 1.2. Prorektori për Hulumtime Shkencore, pranon dhe shqyrton kërkesën nga aplikanti gjegjësisht Stafit Akademik dhe bënë verifikimin e punimit ne platformat Scopus dhe Web of Science,
- 1.3. Pasi te bënë verifikimin, si dhe vlerëson përputhshmërinë e të arriturave kërkimore-shkencore të stafit akademik në bazë të të dhënave për punën kërkimore-shkencore, dhe në pajtim me kriteret e përcaktuara me këtë Rregullore, e miraton punimin dhe procedon tek Prorektori për Financa, për nënshkrim dhe pagese ne baze te kësaj rregulloreje.
- 1.4. Afati për shqyrtimin e Kërkesës duhet te realizohet brenda një muaji,
- 1.5. Kërkesat mund te parashtrohen ne ç' do kohe nga Stafit i rregullt Akademik duke i bashkangjitur edhe një Deklarate nen betim, qe punimi nuk është financuar edhe nga ndonjë institucione tjetër (MASHT, Komune).

Neni 8

Përgjegjësit tjerë për kërkime shkencore

1. Në nivel të fakulteteve, përgjegjës për aktivitete kërkimore shkencore (siç janë Hulumtimet me student) janë Dekani dhe Këshilli i Fakultetit.
2. Aktivitetet kërkimore-shkencore (hulumtimet, analizat, tryezat) në nivel të instituteve te Fakulteteve, mbikëqyren nga Këshillat e Njësive Akademike, duke informuar edhe Prorektorin për Hulumtime-Shkencore.
3. Hulumtuesit individual janë përgjegjës për hulumtimin personal dhe të arriturat e tyre i regjistrojnë në serverin universitar dhe platformat e tjera të njohura nga MASHTI dhe nga universiteti.

Neni 9

Hulumtuesi më i mirë i vitit

1. Bazuar në Ligjin nr. 04/L-135 për veprimtari kërkimore-shkencore, hulumtuesi më i mirë mund të stimulohet me 50% nga paga mujore e tij/saj.
2. Senati çdo vit shpall konkursin për “Hulumtuesin më të mirë të vitit” në Universitet dhe vendos kritere jo më të ulëta se që janë në këtë rregullore.
3. Me vendim të senatit, themelohet komision ad-hoc, me këtë përbërje: Prorektorin për hulumtime dhe kërkime shkencore, nga një anëtar përfaqësues i secilës njësi akademike-staf akademike me përvojë të dëshmuar në punën kërkimore-shkencor, si dhe një student/e ekselent/e i/e propozuar nga Parlamenti Studentor.

4. Hulimtuesi më i mirë i vitit bazohet në pikët që grumbullon hulimtuesi nga punimet e paraqitura para tij:

- 4.1 Hulimtuesi më i mirë i vitit duhet të ketë të publikuar së paku dy punime në Web of Science ose në Scopus, brenda vitit vlerësues.
- 4.2 Punimet e publikuara në revistat ndërkombëtare të indeksuara sipas UA të MASHTI nr.01-2018 datë 19.01.2018 neni 3, paragrafi 1.1, dhe 1.2 saktësisht të indeksuara në Clarivate Analytics - Web of Science (koleksioni bërthamë SCIE, SSCI dhe AHCI) dhe SCOPUS, kanë indeksin e vlerësimit 1.
- 4.3 Punimet e publikuara në revistat rajonale dhe vendore, kanë indeksin e vlerësimit 0.5.
- 4.4 Punimet e prezantuara në konferenca ndërkombëtare me dëshmi të botimit në proceedings, kanë indeksin 0.5.
- 4.5 Tekstet universitare, kanë indeksin 0.7.
- 4.6 Punimet e publikuar në revistën e UKZ-së, kanë indeksin 0.5.
- 4.7 Punimet e prezantuara në konferenca ndërkombëtare me dëshmi të botimit në librin e abstrakteve, kanë indeksin 0.3.
- 4.8 Punimet e prezantuara në konferenca ndërkombëtare si posterë, kanë indeksin 0.3.
- 4.9 Punimet e prezantuara në konferenca rajonale dhe vendore me dëshmi të botimit në librin e abstrakteve, kanë indeksin 0.3.
- 4.10 Çdo citim brenda vitit vlerësues që indeksohet në Web of Science apo në Scholar, ka indeksin 0.1

5. Punimet e publikuara në revista merren në konsideratë nëse kandidati për hulimtues të vitit është autor i parë, autor i dytë ose korrespondent, kurse për punimet në konferenca nëse kandidati është autor i parë ose i dytë.

6. Në të gjitha këto punime autorët prezantohen me adresën e Universitetit Kadri Zeka (affiliations).

Kapitulli III

Dispozitat financiare

Neni 10

1. Veprimtaria kërkimore - shkencore financohet nga buxheti i UKZ-së, MASHTI, dhe partnerët dhe donatorët e jashtëm bashkëpjesëmarrës në projekte.
2. Me buxhetin për kërkime dhe hulumtime shkencore mbulohen:
 - 2.1 Projektet hulumtuese të fakulteteve;
 - 2.2 Pjesëmarrjen në konferenca shkencore ndërkombëtare;
 - 2.3 Botimi i punimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare;
 - 2.4 Shpenzimet për bashkëfinancim- pjesëmarrje në projekte hulumtuese rajonale dhe ndërkombëtare;

3. Lartësia e mjeteve financiare për veprimtari kërkimore shkencore caktohet me buxhetin UKZ-së, të miratuar nga Këshilli Drejtues. Në rast që kërkesat janë më të larta se buxheti i planifikuar, mjetet financiare ndahen në mënyrë proporcionale.

4. Skema e financimit paraqitet sipas tabelës me sa vijon:

Tabela 1. Publikime shkencore

Nr.	Indeksi/databaza	Shuma	Punime për vit
1.	Web of Science (SCIE, SSCI, AHCI)	1,000.00 €	punimi 1 deri 3
2.	Scopus	1,000.00 €	punimi 1 deri 3
3.	Tekstet universitare	1,500.00€	1 në vit
4.	Monografitë	1,000.00 €	1 në vit

5. Botimi në revista shkencore ndërkombëtare financohet nga UKZ-ja në këtë mënyrë:

- 5.1 Nëse punimi ka më shumë se një autorë, atëherë shuma sipas tabelës 1 ndahet 60:40 mes autorit të parë dhe atij korrespondent.
- 5.2 Kërkesën e publikimit të punimit e bënë vetëm njeri nga autoret (autori i parë apo korrespondent, duke marr miratimin me nënshkrim edhe nga bashkautori), ndërsa inkasimi i mjeteve financiare, derdhen të parashtruesi i kërkesës. Ndërsa ndarja e mjeteve e bëjnë mes vete autoret në bazë të pikës 5.1 të kësaj rregulloreje.
- 5.3 Nëse punimi ka bashkautorë jashtë UKZ-së, atëherë stafi i UKZ-së financohet me 100% të vlerës nëse është autor i parë ose korrespondent¹.

6. Për publikimet të cilat janë mbështetur financiarisht nga institucione të tjera në vend, nuk mund të kërkohet mbështetje financiare.

Kapitulli IV

E drejta për mbështetje financiare

Neni 11

1. Për të fituar të drejtën për mbështetje financiare personeli akademik që ka publikuar tërësisht ose një pjesë të konsiderueshme të rezultatit të punës kërkimore të bërë në dhe për Universitetin Kadri Zeka, duhet të argumentojë me sa vijon:

- 1.1 Artikuj me tekst të plotë (punime origjinale empirike, rishikim literature, prezantime të projekteve hulumtuese, rast studimor, letra për editorin, etj.) që bartin adresën e Universitetit Kadri Zeka (affiliations), të botuara në revista shkencore të mbuluara nga Clarivate Analytics – Web of Science (Grupi 1: SCIE, SSCI, dhe AHCI).

¹ Nëse punimi nuk ka të identifikuar autorin korrespondentë atëherë autori i dytë konsiderohet autor korrespondent.

- 1.2 Artikuj me tekst të plotë (punime origjinale empirike, rishikim literature, prezantime të projekteve hulumtuese, rast studimor, letra për editorin, etj.) që bartin adresën e Universitetit Kadri Zeka (affiliations), të botuara në revista shkencore që nuk mbulohen nga Clarivate Analytics – Web of Science, të indeksuara në SCOPUS (*Grupi 2: Q1; Q2; Q3; dhe, Q4*).

Neni 12

1. Me buxhetin për kërkime dhe hulumtime shkencore mbulohen edhe shpenzimet për botimin e teksteve universitare dhe monografive nga stafi akademik me orar të plotë, në pajtim me Rregulloren për Punën e Këshillit Botues të Universitetit “Kadri Zeka” Gjilan.

Neni 13

1. Në rastet të pjesëmarrjes apo organizimit të konferencave shkencore vendore, rajonale dhe ndërkombëtare, të punëtorive dhe seminareve, stafi akademik paraqet kërkesë për mbështetje nga Këshilli Drejtues.
2. Këshilli Drejtues vendos rreth përkrahjes dhe vlerës së përkrahjes në bazë të vlerës së propozuar dhe rëndësisë së aktivitetit dhe përputhjes me drejtimin strategjik të UKZ-së.

Kapitulli V **Transparenca**

Neni 14

1. Zbatimi i kësaj rregulloreje bëhet në përputhje me procedurat e parapara në statutin e UKZ-së dhe kërkesat nga Stafi Akademik mund të paraqiten në momentin e publikimit të punimit apo aktivitetit shkencor,
2. Në raportin vjetor të punës Menaxhmenti, drejtuar Këshillit Drejtues harton dhe publikon listën përfundimtare të përfituesve nga mbështetja financiare.
3. Lista përfundimtare e përfituesve duhet të përmbajë: emrin e përfituesit, fushën apo aktivitetin e financuar dhe shumat që u janë ndarë.
4. Publikimi i përfituesve bëhet në ueb faqen e universitetit.

Neni 15

Dispozitat kalimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregulloja për veprimtarinë kërkimore – shkencore në Universitetin Publik “Kadri Zeka” Gjilan, nr. 02/804 e datës 12.05.2022.

Neni 16

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i UKZ-së dhe zbatohet me nënshkrimin e saj.



Këshilli Drejtues i UKZ-së

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Arta Istrefi', is written over a horizontal line.

PhD Cand. Arta Istrefi - Kryesuese